



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Pristina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,
mbajtur më 25.5.2026, e cila filloi në orën 10:15.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina (Lidhja për Prishtinën) - kryesues i Kuvendit, Bekim Gashi (LDK), Fadil Aliu (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Dhurata Jahaj Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Agron Canolli (PDK), Elmi Fazliu (PDK), Agnesa Avdyli Vitia (PDK), Ilirik Musliu (PDK), Yll Muriqi (PDK), Muhamet Ademi (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani Ramadani (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fjolla Vukshinaj Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida Bujari (LVV), Berita Abazi Muhadri (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumniye Mikullovci (LVV), Leonora Shabani Bajraktari (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Arbentia Murseli Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Teuta Kadiu Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Endrit Zabërgja (NISMA), Jeton Mehmeti (GUXO), Valbona Ajeti (e pavarur), Yll Bogaj (i pavarur).

Munguan: Milazim Vitija (LDK), Mrika Limani Myrtaj (LVV), Çlirim Gërbeshi (LVV), Besa Shahini (PSD), Betim Abdullahi (i pavarur).

Të pranishëm ishin edhe: Florian Dushi, nënkryetar i komunës, Besianë Musmurati, nënkryetare e komunës, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Brahim Mehmetaj - drejtor i Drejtorisë së Pronës, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, Driton Bardheci - drejtor i Drejtorisë së Administratës, Bujar Gashi - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Arianit Elshani - drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Zyhrije Pllana - drejtore e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Albana Gjonbalaj - drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Jeta Rafuna Hasani - drejtore e Drejtorisë së Bujqësisë, Adelinë Sahiti - drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Geci - drejtor i Drejtorisë së Sportit, Pëllumb Bajçinovci - drejtor i Drejtorisë së Mobilitetit, Donat Gashi - drejtor i Drejtorisë së Rinisë, Isah Mustafa - drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Gent Begolli - drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Leutrim Retkoceri - drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Rrezarta Aliu - drejtore e Drejtorisë së Turizmit, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it dhe të mediave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina - kryesues i kuvendit, ku pas verifikimit të kuorumit, u konstatua se janë të pranishëm 45 asamblistë, duke siguruar kuorumin e nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes. Kryesuesi i njoftoi të pranishmit për disa ndryshime në përbërjen e Kuvendit, ku z. Pëllumb Bajçinovci nga radhët e LDK-së, Leutrim Retkoceri nga radhët e PDK-së, Besianë Musmurati nga radhët e PDK-së dhe Granit Geci nga radhët e PDK-së nuk janë më anëtarë, për shkak të emërimit në pozita drejtuese në komunë. Në vend të tyre, mandatin e asamblistit e marrin z. Driton Rukiqi nga radhët e LDK-së, Elmi Fazliu nga radhët e PDK-së, Agnesa Avdyli Vitia nga radhët e PDK-së dhe Muhamet Ademi nga radhët e PDK-së, ku në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dhanë betimin solemn dhe zyrtarisht morën detyrën si anëtarë të Kuvendit të komunës.

Kryesuesi vazhdoi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Propozim – vendimi për rishqyrtimin e vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2025-2026.

Valbona Makolli: - drejtore tha se të gjitha dokumentet për bartjen e mjeteve janë dërguar në Ministrinë e Financave për rishqyrtim, ndërsa këto mjete paraqesin obligime në pritje për ekzekutim të pagesave. Ajo ka kërkuar nga Ministria e Pushtetit Lokal jo vetëm rishqyrtimin e vendimeve të Kuvendit komunal, por edhe mbështetje konkrete për problemet financiare të komunave, veçanërisht të kryeqytetit, ku theksoi se sistemi i tatimit në pronë nuk funksionon prej më shumë se 9 muaj, duke shkaktuar probleme të shumta përmbarimore. Drejtoresha tha se sfida kryesore mbeten zotimet shumëvjeçare të komunave, për shkak të pamundësisë për mbledhjen e plotë të të hyrave sipas rregulloreve.

Egzon Pacolli: - i uroi asamblistët dhe drejtorët e rinj për mandatin, duke shprehur dëshirën që drejtorët të jenë të pranishëm në çdo seancë në të ardhmen. Ai theksoi se të gjitha diskutimet lidhur me pikën e rendit të ditës janë përmbyllur në seancën e kaluar dhe se grupi i tyre e mbështet këtë pikë.

Ilirik Musliu: - deklaroi se qëndrimi i Partisë Demokratike të Kosovës lidhur me bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026, e kthyer nga MAPL-ja për rishqyrtim dhe miratim, mbetet i pandryshuar. Ai theksoi se diskutimet janë zhvilluar në seancën e kaluar dhe se grupi e mbështet këtë pikë për të shmangur pengesat dhe bllokadat në projektet që lidhen me qytetarët e kryeqytetit.

Feim Osmani: - deklaroi se pika për bartjen buxhetore ishte paraqitur edhe në seancën e kaluar dhe kishte marrë përkrahje nga grupet politike, ndërsa rikthimi i saj erdhi si pasojë e mungesës së kuorumit gjatë votimit. Ai përsëriti kërkesën e grupit të LVV-së për ndarjen e 50.000 eurove për ndërtimin e një sheshi në kampusin universitar, duke theksuar se kjo kërkesë nuk ishte përfshirë në tabelat buxhetore, pavarësisht kohës së mjaftueshme për ta bërë këtë. Osmani tha se bartja

buxhetore prej 10.8 milionë eurosh është krijuar për të mbuluar boshllëqet financiare të shkaktuara nga vetë pushteti dhe shumica e mjeteve nuk ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve, megjithatë, LVV-ja ka qenë e gatshme ta mbështesë bartjen për të mos bllokuar funksionimin e projekteve dhe për shkak të orientimi të mjeteve është kompetencë e ekzekutivit. Ai kërkoi që në këtë bartje buxhetore të përfshihet edhe shuma prej 50.000 eurove për ndërtimin e sheshit, duke theksuar se projekti lidhet me memorien kolektive, memorialin dhe krenarinë kombëtare, si dhe me Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Arbenita Murseli: - deklaroi se Lidhja e Prishtinës, e mbështet bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026, ashtu siç ishin dakorduar edhe në seancën e kaluar.

Gëzim Sveçla: - deklaroi se mbajtja e seancës së jashtëzakonshme është pasojë e mosrespektimit të procedurave dhe normave ligjore nga ekzekutivi, duke theksuar se shumë vendime janë kthyer për rishqyrtim nga ministritë përkatëse. Ai tha se kjo qasje ka shkaktuar vonesa dhe humbje financiare për komunën, përfshirë pamundësinë për t'i shfrytëzuar rreth 10 milionë euro. Sveçla ritheksoi kërkesën e LVV-së për ndarjen e 50.000 eurove për ndërtimin e një sheshi në kampusin universitar dhe kërkoi nga drejtoresha sqarim nëse kjo kërkesë është shqyrtuar dhe mund të përfshihet në bartjen buxhetore. Gjithashtu kritikoi mungesën e kryetarit në seancë, duke e cilësuar si injorim të Kuvendit komunal.

Valbona Makolli: - drejtore, sqaroi se kërkesa për ndarjen e 50.000 eurove nuk mund të përfshihet në bartjen buxhetore, pasi rregullorja dhe ligji parashohin që fillimisht të mbulohen obligimet ekzistuese dhe vetëm më pas projektet e reja. Ajo theksoi se kërkesa do të merret parasysh gjatë dëgjimeve buxhetore për vitin 2027 dhe se vlera e propozuar nga z. Osmani pritet të përfshihet në buxhetin e atij viti.

Kryesuesi konstatoi se kishte kuorum, me 46 asamblistë të pranishëm dhe hodhi në votim pikën e rendit të ditës:

Ku me 34 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, u miratua Vendimi për rishqyrtimin e vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2025-2026.

Mbledhja përfundoi në orën 10:33.

Procesmbajtësi
Skender Tora

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina

